

Qk3.



**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

***“WaM Solutions SH.P.K”***

Sot, më datë 14/08.2018 ndërmjet:

- U paraqit personalisht **Z. SERGIO SENESI**, lindur në Genova (Itali), me 14/08/1960 dhe banues ne Tirane, Rruga “Bardhok Biba”, Hyrja 2, Ap.22, Kati 8 , me numër karte identiteti italiane AY8344167.
- kanë vendosur të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“WaM Solutions SH.P.K”** si më poshtë:

**Artikulli 1**

Personi i Siperpermendor, me vullnetin e tij të lirë dhe me liri të plotë në bazë të ligjeve shqiptare, themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar **“WaM Solutions SH.P.K”**

Ortaku i vetem i shoqërie me 100% te kuotave me vlere nominale prej 1,000,000 lekesh (nje milion lek) eshte :

- **Z. SERGIO SENESI**, lindur në Genova (Itali), me 14/08/1960 dhe banues banues ne Tirane, Rruga “Bardhok Biba”, Hyrja 2, Ap.22, Kati 8, me numër karte identiteti italiane YA8786139.
- Bazuar ne nenin 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008, i siperpermenduri **Z.SERGIO SENESI** eshte gjithashtu dhe Administrator i kësaj shoqërie per nje periudhc 5 vjecarc c rinovucshmec automatikisht .

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do të konsiderohet i përshtatshëm nga ana e saj dhe me aprovin e organeve kompetente (Qëndra Kombëtare e Regjistrimeve).

**Artikulli 2**

Shoqëria **“WaM Solutions SH.P.K”** gëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi.

**Selia e saj është në: Durrës, Lagja 3, Rruga Grigor Durrsaku Egt Center 19/10-11,**  
Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.  
Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrinin **“WaM Solutions SH.P.K”**

**Artikulli 3**

Aktiviteti i shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet.



#### Artikulli 4

Shoqëria "**WaM Solutions SH.P.K**" ka si objekt të sajin;

Te veproje per llogari te vete apo per persona te trete, duke respektuar ligjet, si ne Republiken e Shqiperise ashtu edhe jashte kufijve, te aktiviteteve te pasqyruara me poshte :

- a) Aktivitetin e agjentit portual, agjentit doganor, agjentit te udhetimeve dhe zhvillimin e aktivitetit te konsulences menaxheriale per sa i perket turizmit ne nivel internacional;
- b) Ndertimin e anijeve dhe te gjitha aktivitet e lidhura me te;
- c) Transportimin e mallra, njerezve ne rruge tokesore,detare, ajrore, si me mjete te veta ose me mjete te te treteve;
- d) Importimin, eksportimin, fabrikimin, realizimin, asemblimin, instalimin, punimin, rafinimin, magazinimin, mirembajtjen, riparimin, dhenien me qira, tregetimin e produkteve ne te gjitha format qe lejon ligji, aktivitete te lidhura me idrokarburet dhe derivatat e tyre, burime energjitike te te gjitha llojeve, furnizime te lidhura me anijet dhe ato qe jane monopol i shtetit;
- e) Menaxhimin e lokaleve, restoranteve, diskotekave, kinemave dhe aktiviteteve publike;
- f) Organizimin dhe menaxhimin e fshatrave turistike, campingjeve, hoteleve, hosteleve, apartamenteve, Bed & Breakfast, dhe iniziativa ne sektorin turistik dhe te kohes se lire; organizime kongresesh dhe manifestime te te gjitha llojeve. Menaxhimin e sherbimeve te lidhura me argetimin dhe organizimin e ketyre te fundit.
- g) Dhenien me qera, me ose pa shofer per llogari te personave te trete, te automjeteve, anijeve, avioneve, motorcikletave, ciclomotorave, bicikletave etj.; oficinave, elektroautove, autolavazheve, vendet e parkimit per automjetet, motorave, barkave, dhe te cfaredo lloji tjeter mjeti te levizshem;
- h) Botime;
- i) Sherbime te te gjitha llojeve te lidhura me sektorin informatik, te programimit, te projektimit dhe zhvillimin e software-ve, sherbime te lidhura me webmarketing-un, me telemarketing-un dhe te komunikacionit me te gjitha mjetet, sherbime te lidhura me kerkime tregu dhe me permunimin e te dhenave, edhe kontabili, per llogari te personave te trete dhe zhvillimin e sherbimeve te lidhura me administrimin ne per gjithesi duke perfshire edhe konulencen administrative dhe teknike ne lidhje me call-centeret;
- j) Kembim valute;
- k) Caktimin dhe /ose emerimin e manditit te agjensise dhe/ose perfaqesise me apo pa depozite, brokerim, komision, ashtu si dhe kryerja e iniciativave promocionale dhe/ose publicitare te cilat jane te lidhura me aktivitetet e siperpermendura;

m) Sherbime te lidhura me asistencen teknike, menaxhuese ose te strategjive te firmave, drejtuese, tregtare dhe administrative.

Per arrijen e objektivave sociale Shoqeria, mund te permbushe cdo operacion te lidhur me pasurite e tundshme, te patundshme, tregtare, industriale, artizanale, drejtuese, rurale, pyjore dhe financiare, dhenien e garancive reale dhe personale edhe ne favor te personave te trete, blerjen e pronave, si dhe ushtrimin e aktiviteteve industriale dhe tregtare te lidhura me aktivitetin e firmes, dhe te gjitha aktivitetet qe aministratoret mendojne se mund te jene te lidhura ne menyre

#### Artikulli 5

Kapitali i kësaj shoqërie është 1.000.000 (një milion) lekë , i përbërë nga 1 kuote prej vlore nominale 1.000.000 lekë. Kuotat në fjalë janë caktuar si më poshtë:

- Ortaku i vetem i shoqerise **Z. SERGIO SENESI**, lindur në Genova (Itali), me 14/08/1960 , banues ne Tirane, Rruga "Bardhok Biba", Hyrja 2, Ap.22, Kati 8 , me numër karte identiteti italiane AY8344167.

#### Artikulli 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga aktiviteti i kësaj shoqërie, nëse do të shpërndahet, do t'i caktohet ortakëve në bazë të kuotave të pjesëmarrjes që disponojnë në kapitalin e shoqërisë.

#### Artikulli 7

Për detyrimet ndaj të tretëve që do të krijohen gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet eskluzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ortakët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përvçese brenda kufijve të kapitalit të vetë shoqërisë.

#### Artikulli 8

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri dhe filialet e saj rregullohen përmes Kontratës së Punës.

#### Artikulli 9


Dispozita më të thelluara mbi organizimin e kësaj shoqërie janë të specifikuara në statutin e shoqërisë.

Themeluesit e shoqërisë e kanë lexuar kete akt themelimi, e kanë konsideruar të pranueshëm ndaj vullnetit të tyre dhe e kanë firmosur pa kundërshtime.

ORTAKU I SHOQËRIS  
SERGIO SENESI

SERGIO SENESI

B. B. B.



## STATUTI

### TITULLI I ( EMERTIMI – OBJEKTI – KOHËZGJATJA – SELIA )

#### Art. 1 – Emërtimi

1.1 është aktuale një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin “*WaM Solutions SH.P.K*”

#### Art. 2 – Selia e shoqërisë dhe vendqëndrimi i ortakëve

2.1 Shoqëria ka selinë zyrtare ( ligjore ) në Durrës , Lagjja 3 Rruga “Grigor Durrsaku” Egt Center 19/10-11.

2.2 Shoqëria , sipas modaliteteve ( rrugë proceduriale ) ligjore , mund të krijojë filiale , agjensi, përfaqësi ( zyra përfaqësimi ), magazina dhe depo , degë , pika kontakti dhe zyra si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.

2.3 Vendqëndrimi i ortakut te vetem , përsa i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai i përcaktuar në aktin e themelimit, ose më saktë në komunikimin e fundit ( shpalljen ) të bërë nga shoqëria.

#### Art. 3 – Objekti i shoqërisë

##### 3.1 Shoqëria ka si objekt :

Shoqeria ka si objekt ushtrimin, per llogari te vete apo per persona te trete, duke respektuar ligjet, si ne Republiken e Shqiperise ashtu edhe jashte kufijve, te aktiviteteve te pasqyruar me poshte :

- a) Aktivitetin e agjentit portual, agjentit doganor, agjentit te udhetimeve dhe zhvillimin e aktivitetit te konsulences menaxheriale per sa i perket turizmit ne nivel internacional;
- b) Ndertimin e anijeve dhe te gjitha aktivitet e lidhura me te;
- c) Transportimin e mallra, njerezve ne rruge tokesore, detare, ajrore, si me mjete te veta ose me mjete te te treteve;
- d) Importimin, eksportimin, fabrikimin, realizimin, asemblimin, instalimin, punimin, rafinimin, magazinimin, mirembajtjen, riparimin, dhenien me qira, tregetimin e produkteve ne te gjitha format qe lejon ligji, aktivitet te lidhura me idrokarburet dhe derivatat e tyre, burime energjitike te te gjitha llojeve, furnizime te lidhura me anjet dhe ato qe jane monopol i shtetit;
- e) Menaxhimin e lokaleve, restoranteve, diskotekave, kinemave dhe aktiviteteve publike;
- f) Organizimin dhe menaxhimin e fshatrave turistike, campingjeve, hoteleve, hosteleve, apartamenteve, Bed & Breakfast, dhe iniziativa ne sektorin turistik dhe te kohes se lire; organizime kongresesh dhe manifestime te te gjitha llojeve. Menaxhimin e sherbimeve te lidhura me argetimin dhe organizimin e ketyre te fundit.
- g) Dhenien me qera, me ose pa shofer per llogari te personave te trete, te automjeteve, anijeve, avioneve, motorcikletave, ciclomotorave, bicikletave etj.; oficinave, elektroautove, autolavazheve, vendet e parkimit per automjete, motorave, barkave, dhe te cfaredo lloji tjeter mjeti te levizshem;
- h) Botime;

A handwritten signature in black ink, likely belonging to the author or a witness, is placed at the bottom right corner of the document.

- i) Sherbime te te gjitha llojeve te lidhura me sektorin informatik, te programimit, te projektimit dhe zhvillimin e software-ve, sherbime te lidhura me webmarketing-un, me telemarketing-un dhe te komunikacionit me te gjitha mjetet, sherbime te lidhura me kerkime tregu dhe me permunimin e te dhenave, edhe kontabili, per llogari te personave te trete dhe zhvillimin e sherbimeve te lidhura me administrimin ne perjithesi duke perfshire edhe konulencen administrative dhe teknike ne lidhje me call-centeret;
- j) Kembim valute;
- k) Caktimin dhe /ose emerimin e manditit te agjensise dhe/ose perfaqesise me apo pa depozite, brokerim, komision, ashtu si dhe kryerja e iniciativave promocionale dhe/ose publicitare te cilat jane te lidhura me aktivitetet e siperpermendura;
- l) Blerje, shitje te aksioneve ne shoqeri te te gjitha tipeve, qe jane themeluar ose ne faze themelimi qe kane objekt social te njejte ose te ndryshem nga objekti social i firmes perfshire ketu aktivitet e vleresimit dhe menaxhimit te ketyre te fundit;
- m) Sherbime te lidhura me asistencen teknike, menaxhuese ose te strategjive te firmave, drejtuese, tregtare dhe administrative.

Per arritjen e objektivave sociale Shoqeria, mund te permbushe cdo operacion te lidhur me pasurite e tundshme, te patundshme, tregtare, industriale, artizanale, drejtuese, rurale, pyjore dhe financiare, dhenien e garancive reale dhe personale edhe ne favor te personave te trete, blerjen e pronave, si dhe ushtrimin e aktiviteteve industriale dhe tregtare te lidhura me aktivitetin e firmes, dhe te gjitha aktivitetet qe amministratoret mendojne se mund te jene te lidhura ne menyre

**3.2 Aktivite shtesë atyre themeltare në përputhje me objektin e shoqërisë.**

#### **Art. 4 – Kohëzgjatja ( jetëgjatësia ) e shoqërisë**

**4.1 Jetëgjatësia e shoqërise është e përcaktuar per me shume se 10 vjet ( dhjete vjet ), pa përashtuar zgjatjet ose shkrirjen e parakohshme të miratuara nga Asamblea e Ortakëve.**

## **TITULLI II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESMARRJA E ORTAKËVE**

#### **Art. 5 – Kapitali i shoqërisë , kuotat e pjesmarrjes.**

**5.2 Kapitali i shoqërisë është 1,000,000 ( nje milion ) leke dhe është i ndarë në kuota ashtu sic parashikohet ne aktin e themelimit ; i cili mund të shtohet ose pakësohet me vendim të posaçëm të asamblesë së ortakëve dhe kontributet mund të bëhen në natyrë ose shkëmbime financiare.**

**5.2 Të drejtat mbi shoqërinë u përkasin ortakëve në përputhje me masën proporcionale të pjesmarrjes që diponon secili ortak.**

#### **Art. 6 – Tranferimi i kuotave.**

**6.1 Tranferimi i pronësisë apo të të tjera të drejtave reake mbi kuotat e shoqërisë është i lirë në rastin e kalimit trashëgimor.**

**6.2 Tranferimi i mjesmarrjes midis të gjallëve , nga ana tjetër , duhet të ndodhë vetëm në favor të ortakëve të rinj për të cilët asamblea , me shumicë të kapitalit të shoqërisë , të ketë dhënë pëlqimin e saj.**



**TITULLI III**  
**VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

**Art. 7 – Vendimet e ortakëve**

7.1 Ortakët vendosin përmes " Asamblesë së Ortakëve " mbi cështjet e mëposhtme të cilat u janë rezervuar atyre si kompetenca :

- modifikimet e statutit;
- vendimet për të ndermarrë operacione që kanë të bëjnë me modifikimin e objektit të shoqërisë ose një modifikim të të drejtave të ortakëve;
- vendimet e lidhura me shpërndarjen e fitimeve;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- aprovimin e bilancit të periudhës ushtrimore;
- vënien në likujdim të shoqërisë;
- çdo vendim tjetër për të cilin të paktën njeri prej administratorëve të kërkojë rezolutën e Asamblesë.

7.2 Asambletë mund të mbahen edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë:

1. duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm presidenti dhe sekretari i mbledhjes.
2. Duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje;
3. duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuar si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale.  
Egzistenza reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në rastin kur asamblea duhet të mbahet ne audio – videokonferencë ose në audiokonferencë , në lajmërimin e thirrjes duhet të përcaktohet ora e fillimit të lidhjes telematike dhe vendet e audio – video konferencës të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të cilëve do t'i bashkohen pjesmarrësit: në cdo vend mbledhjeje duhet të mbahet një procesverbal i pjesmarrjes.

**Art. 8 – Efikasiteti i vendimmarries së asamblesë**

8.1 Asambletë e formuara dhe të thirruara rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e tërheqjes sic parashikohet në ligj.

**Art. 9 – Thirrja dhe vendi i Asamblesë**

9.1 Asambleja e ortakëve , e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve,këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit , nëse ata janë emëruar të paktën tetë ditë përpara datës së fiksuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i interesuar i ka dhënë shoqërisë.

9.2 Lajmërimi i thirrjes duhet të përbajë përshkrimin e ditës , orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe argumentet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

9.3 Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

9.4 Lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e këtij njoftimi.

**Art. 10 – Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble**

10.1 Mund të ndërhyjnë në asamble të gjitha ata që rezultojnë të janë ortakë në datën e asamblesë.

10.2 Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një prokure të shkruar të dorëzuar ose me fax ose me postë elektronike nga një person tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak.

10.3 Prokura nuk mund të lëshohet e pashkruar.

**Art. 11 – Presidenti i asamblesë**

11.1 President i asamblesë është ose administratori i vetëm ose nga presidenti i këshillit të

administrimit, në rastin e emëritimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përzgjedhur nga asambleja.

11.2 Për të arritur tek kjo përzgjedhje mbledhja duhet të drejtohet përkohësisht nga personi me moshën më të madhe i cili është i pranishëm në asamble.

11.3 Asambleja zgjedh sekrtarin dhe nëse është e nevojshme dy komisioner.

11.4 Vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të firmosur nga presidenti dhe sekretari i ; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.

11.5 Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e mbajtjes së aamblesë , certifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishëmve, rregullon zhvillimin e saj dhe certifikon rezultaten e votimeve.

Art. 12 – Vendimet e asamblesë

12.1 Në thirrjen e parë asambleja ngrihet rregullisht me pjesmarjen e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë së përmendur dhe merr vendime me shumicë unanime.

12.2 Në mbledhjen e dytë mbajtja e asamblesë është e vlefshme sado që të jetë pjesa e kapitalit të shoqërisë që disponojnë të pranishmit dhe merr vendime në bazë të shumicës së votave të të pranishmëve.

12.3 Për më tepër , mbi modifikimet e aktit të themelimit dhe mbi emërimin dhe fuqitë e likujdusves , asambleja mund të mbahet rregullisht dhe vendimet e saj të jenë të vlefshme qoftë në thirrjen e parë ashtu edhe në të dytën vetëm me prezencën e me shume se 75% të ortakëve dhe me votën pro të aq ortakëve sa të arrihet shumica e kapitalit të shoqërisë.

## TITULLI IV ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Art. 13 – Administrimi i shoqërisë

13.1 Shoqëria administrohet , në varësi të asaj që vendoset herë pas here nga asambleja e ortakëve , nga një administrator i vetëm ose nga një këshil administrativ i përbërë nga dy ose pesë anëtarë , të emëruar edhe midis atyre të cilët nuk janë ortakë.

13.2 Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve do të përcaktohet nga ortakët në aktin e emëritimit dhe mund të jetë edhe me kohë të papërcaktuar.

13.3 Shpërblimi dhe pjesmarja në fitime e administratorit të vetëm dhe anëtarëve të këshillit administrativ përcaktohen nga ortakë.

13.4 Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsyet e detyrës së tyre.

13.5 Shpërblimi i administratorëve të veshur me detyra të posacme, dhe gjithsesi të ndonjë administratori të deleguar , përcaktohet nga këshilli administrativ.

Art. 14 – Presidenti , zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar

14.1 Në rastin e emëritimit të një këshilli administrativ, nëse nuk e kanë bërë ortakët, ky i fundit zgjedh midis anëtarëve të tij presidentin , zv.presidentin i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pamundësie të tij me fuqitë dhe kufizimet të përcaktuar kohë pas kohe nga këshilli administrativ.

Art. 15 – Vendimet e këshilit administrativ

15.1 Vendimet e këshillit administrativ merren me maledhje kolegiale.

15.2 Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

Art. 16 – Mbledhja kolegiale e këshillit administrativ.

16.1 Këshilli administrativ do të mblidhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjeter në Shqipëri ose jashtë , cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

16.2 Si rregull thirrrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë që mund të provohet marra e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë

ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përjashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

16.3 Këshilli administrativ mund të mbahet rregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpermendura , nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e oranit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar , pa anashkaluar të drejtën e secilit pjesmarrës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsidron se nuk është informuar mjafthueshëm.

16.4 Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë:duhet të zgjidhe një vend ku të janë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuarë si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenza reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

16.5 Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të janë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japid vota kundër ose abstenojnë , vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

Art. 17 – Vendime të marra me mbledhje kolegiale

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posacëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

Art. 18 – Fuqitë e organit administrativ

18.1 Organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca eksluzive të vendimeve të ortakëve.

18.2 Këshilli i administrimit ose administratori i vetëm do të ketë pra , ndër të tjera , të drejtën për të blerë , shkëmbyer , shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme , automjete , ti përfshijë në shoqëri , të marrë aksione dhe interesa , të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh , drejtore e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë një pjesë ose të gjithë atributet dhe fuqitë e tij dhe ato të presidentit , përfshirë edhe firmën e shoqërisë , njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij duke mirëpërcaktuar atributet ose penalitetet si edhe shpërbilimet në kufijtë dhe format që ai do ta gjykojë të përshtatshme.

Art. 19 – Firma dha përfaqësimi i shoqërisë

19.1 Përvec rasteve të parashikuar në artikullin e mëparshëm 18.3 , firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ.

## TITULLI V ORGANI I KONTROLLIT

Art. 20 – Organi i kontrollit.

20.1 Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet dhe të kryhet sipas zgjedhjes dhe me vendim të pronarëve nga një ekspert kontabël. Eksperti kontabël mund gjithashtu të pushohet nga puna nga asambleja e ortakëvë.





## TITULLI VI BILANCI – FITIMET

Art. 21 – Ushtrimi i shoqërisë , bilanci dhe fitimet.

21.1 Ushtrimet e shoqërisë mbyllen më 31 ( tridhjetë e një ) dhjetor të cdo viti. Ushtrimi i parë mbylllet më 31 ( tridhjetë e një ) dhjetor 2013 ( dymjë e trembëdhjetë ).

21.2 Bilanci i hartuar në konformitet me normat e patjetësuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përvèc mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu :

- 5 % ( pesë për qind ) në ngritjen e një fond rezerve ligjore , deri në arritjen e një shume të barabartë më një të pestën e kapitalit të shoqërisë;
- fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihet mënjanë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast , nesë verifikohet humbje kapitali , nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

## TITULLI VII

### SHKRIRJA, PËRJASHTIMI I ORTAKËVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET

Art. 22 – Shkrirja

22.1 Shoqëria quhet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë , ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likujdues dhe do caktojnë fuqitë dhe shpérblimin e tyre.

Art. 23 – Dispozita të përgjithshme

23.1 Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin c themelimit osc në këtë statut , do të bëhet kohë pas kohe një referim i shprehur i ligjeve në fuqi.

*Oktori :  
Bogdani Senesi  
Lipjan*

*14/05/2018*



**ATTO DI COSTITUZIONE**  
**Per la creazione della Società a Responsabilità Limitata**  
**"WaM Solutions SH.P.K"**

In data odierna 14.05. 2018

è comparso personalmente il sig. Sergio Senesi, nato a Genova il 14/08/1960 e residente in Tirana, Rruga "Bardhok Biba", Hyrja 2 Ap. 22, Kati 8, titolare della carta d'identità n. AY8344167 rilasciata dal Comune di Genova in data 28/12/2017;

(documenti tutti allegati sub. 1 al presente atto).

Detto sig. Sergio Senesi dichiara che ha deciso di costituire la società a responsabilità limitata "**WaM Solutions SH.P.K**" come segue:

**Articolo 1**

Il soggetto sopracitato, di propria libera volontà e in piena libertà in base alle leggi Albanesi, costituisce la società a responsabilità limitata (s.r.l) denominata "**WaM Solutions SH.P.K**"

Il 100% delle quote sociali sarà intestato come segue:

Socio Unico di questa società è lo stesso comparente SERGIO SENESI, nato a Genova il 14/08/1960 e residente in Tirana, Rruga "Bardhok Biba", Hyrja 2 Ap. 22, Kati 8, titolare della carta d'identità n. AY8344167 rilasciata dal Comune di Genova in data 28/12/2017. Pertanto detto soggetto sarà titolare di una quota del valore nominale di leke 1.000.000,00 (un milione/zero zero).

Ai sensi dell'art. 95 della Legge 9901 del 14/04/2008 Sempre il medesimo sig. Sergio Senesi viene nominato amministratore unico per durata di 5 anni rinnovabile

La società ha il diritto di creare filiali dentro e fuori dal paese in qualunque momento venga ritenuto opportuno, con l'approvazione degli organi competenti (Centro Nazionale di Registrazione).

**Articolo 2**

La società "**WaM Solutions SH.P.K**" con la sua registrazione presso il Centro Nazionale di Registrazioni, QKR potrà godere dello stato di persona giuridica. La sua attività si svolgerà secondo i punti disposti su questo atto costitutivo, il suo statuto e le leggi in vigore. La sua sede legale è: Durres, Lagja 3, Rruga "Grigor Durraku", tek EGT Center/19. Lo statuto della società si allega a questo atto di costituzione e ne è parte integrante. La società ha il suo timbro con la scritta "**WaM Solutions SH.P.K**"


### **Articolo 3**

L'attività della società come persona giuridica ha inizio con la registrazione dell'atto costitutivo da parte degli organi competenti dello Stato e proseguirà per la durata di più 10 anni, salvo anticipato scioglimento o proroga.

### **Articolo 4**

La società ha per oggetto l'esercizio, sia in proprio che per conto di terzi, nel rispetto delle leggi, sia in Albania che all'estero, delle seguenti attività:

- a) attività di agente portuale raccomandatario marittimo, di spedizioniere doganale, di agente di viaggi e lo svolgimento di attività di consulenza manageriale in ambito turistico a livello internazionale
- b) armamento di navi e tutte le attività previste
- c) trasporto di beni e/o persone per terra, acqua, aria, sia con mezzi propri che di terzi;
- d) Importazione, esportazione, fabbricazione, realizzazione, assemblaggio, installazione, lavorazione, raffinazione, magazzinaggio, manutenzione, riparazione, locazione, commercio di prodotti in tutte le forme previste dalla legge, nonché di idrocarburi e loro derivati, fonti energetiche di ogni tipo, forniture navali ed anche di genere di monopolio statale.
- e) gestione di bar, ristoranti, discoteche, cinematografi, esercizi pubblici;
